ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendi Komunal i Graçanicës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **GRA618-25-2462-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: Shërbimet për hartimin e dokumentacionit teknik i projektit për nevojat e komunës së Graçanicës

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

STUDIO HAPSIRA SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Mat - Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

045 150 123
Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Edmond Halimi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

infostudiohdesign@gmail.com
(Adresa elektronike)

30.06.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Avokat Qëndrim Arifi
(Emri i avokatit)

Rr. "Idriz Gjilani", Llamela 15, Kati 2, Nr. 213, Dardani, Prishtinë.
(Adresa e plotë)

+383 49 875 852 ***N/A***
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

qendrim1.arifi@gmail.com
(Adresa elektronike)

30.06.2025 _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë:26.03.2025
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 15.04.2025
Njoftim mbi Vendimin e AK-së: 21.05.2025
Kërkesë për Rishqyrtim 26.05.2025;
Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues pas Rivlerësimit: 11.06.2025
Kërkesa për Rishqyrtim: 16.06.2025
Vendimi lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim: 19.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 72.3 i LPP-së
Neni 27.3 i RrPP-së
Neni 38.3 i RrPP-së
Neni 41.3 i RrPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Rrjedha e procedurës:

Lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Shërbimet për hartimin e dokumentacionit teknik i projektit për nevojat e komunës së Graçanicës"** me numër të prokurimit

GRA618-25-2462-2-2-1**,** AK fillimisht më datë 21.05.2025 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, me çka ka rekomanduar për kontratë OE-në N.N.SH. "Vizion Project".

Më 26.05.2025 GOE STUDIO HAPSIRA SH.P.K, ; GEOPLAN&CONSULTING GROUP SHPK dhe ITEG SH.P.K. (tutje referuar si STUDIO HAPSIRA SH.P.K) kanë parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së.

AK aprovon ankesën e STUDIO HAPSIRA SH.P.K, duke e kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, ndërsa më 11.06.2025 publikon Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ku përsëri rekomandohet për kontratë OE N.N.SH. "Vizion Project", ndërsa STUDIO HAPSIRA SH.P.K dhe GOE tjetër konkurrues shpallen të papërgjegjshëm.

Kompania STUDIO HAPSIRA SH.P.K., më 16.06.2025 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Graçanicës, duke prezantuar argumentet ligjore që si GOE pjesëmarrës nuk jemi pajtuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpallur fitues OE N.N.SH. "Vizion Project ".

Në Kërkesën për Rishqyrtim STUDIO HAPSIRA SH.P.K., ka ofruar argumente ligjore që mbështesin konstatimet tona se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, kur ka eliminuar si të papërgjegjshme ofertën tonë si dhe kur ka shpallur fitues OE-në N.N.SH. "Vizion Project", duke theksuar se ne jemi i vetmi OE i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kriteret e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues si në dosje të tenderit.

Megjithatë, në refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ofron ndonjë kundër argument ligjor në argumentet tona ligjore dhe padrejtësisht refuzon kërkesën e parashtruar.

Duke pas parasysh të cekurat më lartë, STUDIO HAPSIRA SH.P.K., parashtron Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe atë mbi bazën e shkeljeve të argumentuara në vazhdim.

Pretendimi 1: Eliminimi i kompanisë tonë në kundërshtim me ligjin

AK na ka eliminuar me pretendimin se kinse kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta. Në këtë drejtim më 12.05.2025 nëpërmjet Letrës Standarde për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët ka kërkuar informata lidhur me ofertën tonë.
PROVË: Letra Standarde e datës 2.05.2025.

Nëpërmjet Letrës Standarde AK ka theksuar se: *"Oferta juaj është identifikuar si me çmim jonormalisht të ulët, krahasuar me ofertat e tjera"*. Bazuar në nenin 61 të LPP-së, lidhur me nenin 41.3 të RrPP-së, për tu konsideruar një ofertë jo normalisht e ulët në krahasim me tenderuesit tjerë, atëherë është e domosdoshme që në mënyrë komulative duhet të plotësohen këto tri kushte:

(41.3) Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:
(i). çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
(ii). çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

(iii). janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. **Në rastin tonë kjo dispozitë nuk mund të zbatohet për faktin se asnjeri nga kushtet ligjore NUK është plotësuar, e gjithë kjo për faktin se i vetmi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet jemi ne,** por edhe nëse e marrim versionin e AK-së, i vetmi OE i përgjegjshëm sipas Vendimit të datës 11.06.2025 është OE i rekomanduar për kontratë.
PROVË: Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 11.06.2025.

STUDIO HAPSIRA SH.P.K më 16.05.2025 ka ofruar shpjegime të detajuara për AK-në se pse oferta jonë është e përgjegjshme dhe se aspak nuk ka të bëjë me çmime jo normalisht të ulëta ashtu siç pretendon AK.
PROVË: Sqarimet e ofruara më 16.05.2025.

Në kuadër të sqarimeve ne kemi ofruar edhe dëshmi faktike mbi atë se pse oferta jonë nuk është jo normalisht e ulët dhe atë përtej sqarimeve të kërkuara nga AK. Konkretisht AK në vitin 2023 ka incizuar dhe nënshkruar kontratë për një aktivitet IDENTIK, procedurë dhe vlerë të parashikuar IDENTIKE dhe kishte shpërblyer me kontratë një OE i cili kishte ofruar çmim dukshëm më të lirë se sa që ka ofruar tani STUDIO HAPSIRA SH.P.K.

PROVË: Njoftimi mbi Vendimin e AK-së në aktivitetin me titull: "Shërbimet për hartimin e dokumentacionit teknik i projektit për nevojat e komunës së Graçanicës" dhe numër të prokurimit GRA618-23-6576-2-2-1, i iniciuar në vitin 2023.

Republika e Kosovës
Republika Kosova Republic of Kosovo

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Shërbimet për hartimin e dokumentacionit teknik i projektit për nevojat e komunës së Graçanicës

Nr i prokurimit	**GRA618-23-6576-2-2-1**
Nr i brendshëm	**GRA618-23-018-221**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	Zajednica ponuditelja NEWS SH.P.K.; N.SH. GEO-MAP, L. e Prizrenit, 143, 31000, ISTOG	2.69
2.	Zajednica ponuditelja Enggroup SH.P.K.; Geo- Group SH.P.K., Vëllezrit Gërvalla Bll.8, 10000, PRISHTINË	19.15

KOMUNA E GRACANICËS shpërblen me kontratë **Zajednica ponuditelja NEWS SH.P.K.; N.SH. GEO-MAP, L. e Prizrenit, 143, 31000, ISTOG** në vlerë totale të ofertës **2.69 € me çmime për njësi në bazë të pikëtim.**

Vendimi është marrë pas një sqarimi nga Zajednica ponuditelja NEWS SH.P.K.; N.SH. GEO-MAP që ata dorëzuan bazuar në letrat standarde B41 dhe B47 që dërguam.

Data: **03.08.2023.**

Emri dhe mbiemri i ZPP: Dejan Todorović

Pra, në këtë aktivitet është rekomanduar për kontratë OE me vlerë totale të ofertës **2.69**, ndërsa në aktivitetin e vitit 2025, AK konsideron tender jo normalisht të ulët ofertën tonë me vlerë totale **9.75**, apo gati tre fish më e lartë. Gjithashtu nuk mund të anashkalohet fakti se kur kemi të bëjmë me prokurime të njëjta të cilat prokurohen nga autoritetet siç është tani rasti i shërbimeve për hartimin e dokumentacionit teknik të projekteve, OE-të me të drejtë shikojnë çmimet e ofruara dhe kontraktuara në vitet paraprake, e gjithë kjo me qëllim që të jenë sa më afër çmimit real dhe të ofrojnë një ofertë konkurruese, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se kriteri i përzgjedhjes ka qenë **çmimi më i lirë.** Prandaj është më se e qartë se AK për qëllim ka pasur vetëm të justifikoj disi eliminimin tonë, në mënyrë që ta shpërblej me kontratë OE-në N.N.SH. "Vizion Project", përkundër se është OE i papërgjegjshëm.

Për të argumentuar atë se oferta e STUDIO HAPSIRA SH.P.K. është e përgjegjshme dhe se çmimet e ofruara nuk janë jo normalisht të ulëta, ne kemi ofruar edhe një listë me 40 kontrata të përfunduara nga kompania jonë, për të cilat kemi referenca pozitive. Pra, përkundër që shumica e çmimeve të kontraktuara në dukje të parë mund të jenë të ulëta, ne në asnjërën prej tyre nuk kemi ngecur në përmbushje dhe kjo do të duhet të shërbente si garantues edhe për AK-në.
PROVË: Shih Sqarimet e ofruara më 16.05.2025.

Ne si kompani kemi dhënë të gjitha garancitë tona se i qëndrojmë pranë ofertës tonë, dhe në rast se AK ka edhe dyshimin më të vogël për një gjë të tillë, atëherë ajo mund ta rris sigurinë e ekzekutimit, e jo të na eliminoj nga gara duke shpërblyer me kontratë një OE i cili ka ofruar çmim më të shtrenjtë në këtë aktivitet të prokurimit. Është krejtësisht e pakuptimet dhe jo ligjore që në një aktivitet të prokurimit me **kriterin e përzgjedhjes çmimi mi i lirë**, të rekomandohet për kontratë çmimi **më i shtrenjtë.**

AK në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 11.06.2025 NUK OFRON asnjë argument se pse ose cilat shpjegime të kompanisë tonë nuk qenkan bindëse, për më tej potencon se pretendimet tona nuk janë faktuar, dhe në asnjë rresht të arsyetimit të vendimit për eliminimin tonë nuk merret me dëshminë siç janë lista e kontratave të përmbushura dhe dëshmia se ë njëjtin aktivitet në të kaluarën AK e ka nënshkruar me çmim dukshëm më të lirë. Andaj, si të tillë OSHP këtë vendim duhet ta anuloj si të kundërligjshëm.

Duhet theksuar se secili autoritet kontraktues gëzon të drejtën ekskluzive që në dosje të tenderit të vendos njërin nga kriteret e përzgjedhjes, përkatësisht kriterin e çmimit më të lirë ose çmimit ekonomikisht më të favorshëm. Bazuar edhe në nenin 52, par.1 të LPP, AK në dosje të tenderit, përkatësisht në njoftim për kontratë ka specifikuar se **kriter i përzgjedhjes është çmimi më i lirë**.

Sipas **LPP, neni 1, par, 1** taksativisht theksohet se: *"Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla"*. Me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 11.06.2025 është legjitimuar shpërblimi me kontratë i OE-së i cili me çmim ishte dukshëm më i lartë dhe duke keq shfrytëzuar fondet publike.

Sipas **LPP, neni 6, par.1** taksativisht theksohet se: "*Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".* Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është në kundërshtim të plotë me këtë nen, sepse pikërisht ndodh e kundërta, pra AK rekomandon për kontratë OE-së N.N.SH. "Vizion Project", i cili ka ofruar çmim dukshëm më të lartë, konkretisht çmimin më të lartë nga gjithsej tri oferta pjesëmarrëse.

Me Vendimin e atakuar, është shkelur neni 59 dhe 60 i LPP-së. Përkatësisht gjatë procesit të rivlerësimit AK nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 59. Ndërsa sipas nenit 60, par.1.1. të LPP-së, *"Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose (1.1)* ***tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;*** *(1.2) tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji"*. Ndërsa bazuar në nenin 25, par. 5 të RrPP *"Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar*". Pra, AK ka përzgjedhur kriterin **çmimi më i ulët**, ndërsa përkundër që kemi ofruar çmim më të ulët dhe kemi argumentuar se pse jemi të përgjegjshëm, AK na ka eliminuar.

Në nenin 27, par. 3 të RrPP, në mënyrë shprehimore thuhet se: *"Nëse kriteri "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuara".* STUDIO HAPSIRA SH.P.K ka qenë OE më i lirë, i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, mirëpo i njëjti është eliminuar kundërligjshëm për faktin se kinse ka ofruar çmim jo normalisht të ulët, përkundër faktit se të njëjtin tender AK gjatë vitit 2023 e kishte nënshkruar me çmim dukshëm më të ulët se sa oferta jonë.

Pretendimi 2: AK rekomandon për kontratë N.N.SH. "Vizion Project" i cili është OE i papërgjegjshëm

AK edhe në Vendimin e datës 21.05.2025, por edhe me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 11.06.2025 ka rekomanduar për kontratë OE-në N.N.SH. "Vizion Project", i cili **është OE i papërgjegjshëm.**

Në kuadër të kërkesave lidhur me kapacitetin teknik profesional, AK kishte kërkuar edhe: *"(13.) Inxhinier Diplomuar i Gjeodezisë minimum Tre (3) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bachelor i Gjeodezisë minimum Pese (5) vite pervoj pune pas diplomimit.* ***Te jete i Licencuar nga autoriteti përkatës i Republikës së Kosovës per kryerjen e shërbimeve Gjeodezike****".* Ndërsa si dëshmi kishte kërkuar: *"(13) CV e përvojës së punës e nenshkruar nga vete inxhinieri. Diploma Kopje.* ***Licenca Kopje****. Referenca të punës. Kontratë Pune kopje nese është në mardhënie të rregullt pune ose Parakontratë apo Marrëveshje Bashkëpunimi duke specifikuar titullin e kontratës, emrin e AK si dhe numrin e prokurimit*".

13. Inxhinier Diplomuar i Gjeodezisë minimum Tre (3) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bachelor i Gjeodezisë minimum Pese (5) vite pervoj pune pas diplomimit. Te jete i Licencuar nga autoriteti përkatës i Republikës së Kosovës per kryerjen e shërbimeve Gjeodezike.	**13. CV e përvojës së punës e nenshkruar nga vete inxhinieri. Diploma Kopje. Licenca Kopje. Referenca të punës. Kontratë Pune kopje nese është në mardhënie të rregullt pune ose Parakontratë apo Marrëveshje Bashkëpunimi duke specifikuar titullin e kontratës, emrin e AK si dhe numrin e prokurimit.**

Foto 1: E shkëputur nga kërkesat e Dosjes së Tenderit

OE i rekomanduar për kontratë N.N.SH. "Vizion Project", për të plotësuar këtë kërkesë kishte ofruar si inxhinier z. Zekrija Elezi, ndërsa për këtë kishte ofruar edhe licencën. Licenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë ishte **e skaduar**. Konkretisht afati i fundit për pranimin e tenderëve ishte datë **15.04.2025**, ndërsa **licenca kishte skaduar më datë 05.03.2025.**

PROVË: Licenca me datë të skadencës 05.03.2025.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova- Government of Kosovo
Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/
Ministry of Infrastructure and Environment
Agjencia Kadastrale e Kosovës/ Kosovska Katastarska Agencija/ Kosovo Cadastral Agency

Në bazë të Ligjit për kadastër Nr. 04/L-013, UA Nr. 13/2019 dhe vendimit të komisionit për licencim nr:010-1-58/20, Agjencia Kadastrale e Kosovës lëshon këtë:
Na osnovu Zakona za katastar Br. 04/L-13 i AU Br. 13/2019 i odluke komisije za licenciranje br. 010-1-58/20 Kosovska Agencija za Katastar izdaje ovu:

LICENCË

Për kryerjen e shërbimeve kadastrale

për

GJEODETIN E LICENCUAR

ZEKIRJA ELEZI

Numri i licencës: 17

Data e dhënies së Licencës / Datum izdavanja Licence: 05.03.2020
Afati i skadimit të Licencës / Datum okončavanja Licence: 05.03.2025

Drejtor Ekzekutiv
Avni HIMETI

Pas Kërkesë për Rishqyrtim të datës, 26.05.2025 që kishte parashtruar OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K., AK kishte kthyer lëndën në rishqyrtim, duke e konsideruar këtë çështje si lëshim teknik të komisionit, ndërsa gjatë rivlerësimit OE të rekomanduar për kontratë i kishte kërkuar sqarime shtesë, ndërsa i njëjta kishe ofruar një licencë valide, mirëpo e njëjta është lëshuar **më 22.05.2025, apo 37 ditë pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve.**

PROVË: Licenca e lëshuar më datë 22.05.2025.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Agjencia Kadastrale e Kosovës/ Kosovska Katastarska Agencija/ Kosovo Cadastral Agency

Në bazë të Ligjit për kadastër të pronës paluajtshme Nr. 08/L-237, UA Nr. 06/2024 dhe vendimit të Komisionit për leje dhë licenca, Agjencia Kadastrale e Kosovës lëshon këtë:
Na osnovu Zakona o katastru nepokretnosti Br. 08/L-237, AU Br. 06/2024 i odluke Komisija za dozvole i licence Kosovska Agencija za Katastar izdaje ovu:

LICENCË

Për kryerjen e shërbimeve kadastrale
për

GJEODETIN E LICENCUAR

Zekirja Elezi

Numri i licencës:17

Data e dhënies së Licencës/ Datum izdavanja Licence: 22.05.2025
Afati i skadimit të Licencës/ Datum okončavanja Licence: 22.05.2030

Kryetar i Komisionit
Nadir Shyqeriu

ud. Drejtor Ekzekutiv
Avni AHMETI

Data/Datum/Date	22.05.2025 12:00

Ky dokument është nënshkruar në formë elektronike.
Ovaj dokument je elektronski potpisan.
This document is signed electronically.

https://ekosova.rks-gov.net/529

Pra, në vend se AK pas kërkesës për informata shtesë të vërtetonte se OE N.N.SH. "Vizion Project" përfundimisht është i papërgjegjshëm, AK në shkelje të detyrimeve ligjore e bënë të kundërtën duke e rekomanduar përsëri për kontratë dhe duke eliminuar padrejtësisht ankuesin OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K. si të papërgjegjshëm.

Me këtë veprim AK në mënyrë direkte ka shkelur **nenin 72, paragrafi 3** të LPP-së i cili taksativisht thekson se: "*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet* ***vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të***

***afatit për dorëzimin e tenderëve**, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive".* Pra, përkundër që AK ka pranuar një licencë të skaduar, e njëjta kundërligjshëm kërkon informata shtesë dhe kundërligjshëm pastaj rekomandon për kontratë OE-në i cili ofron licencë me datë të lëshimit 37 ditë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Me këtë veprim AK ka rënë ndesh edhe me Rregulloren për Prokurimin Publik, konkretisht **nenin 38, paragrafi 3**, i cili taksativisht thekson se: *"Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues, gjatë vlerësimit, të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente të cilat mungojnë në aplikacion/tender.* ***Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve".***

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Graçanicës ka bërë shkelje të **nenit 59 paragrafi 2 të LPP-së:** i cili nen taksativisht thekson se: *"Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve.* ***Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues****...",* me rastin e vlerësimit të tenderëve ku OE Storm ICT, na ka shpallur si OE të pasuksesshëm përkundër faktit se ne si OE i plotësojmë të gjitha kriteret e paraqitura si në dosje të tenderit nga AK.

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Graçanicës nuk e ka respektuar edhe **nenin 7 të LPP-së**, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Po ashtu autoritet kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

3. GOE ARCH EMPIRE L.L.C. & ENG IDEA SH.P.K. me të drejtë është eliminuar

AK me të drejtë ka eliminuar GOE ARCH EMPIRE L.L.C. & ENG IDEA SH.P.K., pas sigurimit të qasjes në ofertat e të gjithë kompanive ofertuese, kemi evidentuar se është plotësisht e saktë ajo se ky GOE në pozicionin 3.12 të Kapitullit 3.0 – Hartimi i Elaborateve dhe matjeve gjeodezike, nuk ka vendosur asnjë çmim, dhe ky gabim i jep të drejtë AK-së ta eliminoj të njëjtin pa kërkuar informata shtesë.

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Organit Shqyrtues të Prokurimit, i propozojmë që të merr këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** tërësisht e bazuar Ankesa e parashtruar nga OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 11.06.2025, ashtu që **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Graçanicës, që lëndën ta kthej në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.të shpallet fituese si i vetmi OE i përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, ashtu edhe në fitime të munguara. Vlera e dëmit kap vlerën 300,000.00€, të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar të ja paguaj palës dëmtuar në rast se humb kontekstin Gjyqësorë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*